BANKINGU QENDROR NË KOHËN E INTEGRIMIT

*Seyhan Pencapligil**

ABSTRAKT

Megjithëse konkurrenca në përgjithësi është e mirë, pasi rrit eficiencën, ekziston një marrëveshje midis konkurrencës dhe stabilitetit të tregjeve financiare, kur flitet për sektorin bankar. Kjo në sajë të tipareve unike të sektorit bankar siç janë kthimet e shkallës, informacioni i parregullt, rreziqet e sistemit, likuiditeti, rreziku i lartë dhe kompleksiteti. Prandaj, konkurrenca e madhe më tepër mund të krijojë, sesa të zgjidhë probleme. Në sistemet bankare që karakterizohen nga konkurrenca e fortë, mbikëqyrësit duhet të jenë tepër të kujdesshëm për të parandaluar problemet dhe humbjet në shkallë të gjerë.

Konkurrenca është e mirë, pasi rrit eficiencën, ul çmimet, si dhe rrit zgjedhjen e novacionet. Për shumë sektorë, është mirë të kesh më shumë konkurrencë por jo tepër. Kjo pasi konkurrenca është një proces, i cili nxjerr nga tregu lojtarët më pak eficientë dhe siguron që lojtarët që mbesin, të jenë në ekuilibër për të patur eficiencën dhe nivelet e kërkuara të kthimeve në investime. Për shembull, në qoftë se ka shumë prodhues makinash në një vend, duke lënë mënjanë mundësitë për eksport për hir të argumentit, ata do të shkojnë drejt një lufte çmim/produkti, që do t'i mundësojë atyre kthime në investime të arsyeshme për të mbijetuar dhe për të qenë të sigurt. Rezultat i

kësaj është që nëse kthimet në një sektor janë shumë të larta, duke njohur investimin e kërkuar dhe rreziqet e ndërmarra, atëherë ka mundësi që konkurrenca të mos jetë aq sa duhet (për shembull, ka shumë barriera për të hyrë informacioni i parregullt etj.).

Ndërsa arsyetimi i mëparshëm qëndron në përgjithësi, nuk është aq e qartë që konkurrenca midis bankave do të ndjekë argumentin e gjerë se konkurrenca në industri po rrit eficiencën dhe mirëqenien. Përceptimi konvencional rreth konkurrencës sugjeron që konkurrenca eliminon praktikat e shtrënguara dhe zvogëlon kufijtë ndërmjet normave të huave dhe të depozitave, duke përmirësuar kështu performancën e industrisë bankare.

Ky koncept standard i konkurrencës argumenton se ajo siguron që kostot të minimizohen dhe çmimet e shërbimeve bankare të jenë të tilla që burimet të shpërndahen me eficiencë. Me fjalë të tjera, konkurrenca nxit eficiencën dhe e ndan përfitimin e sistemit financiar me pjesën tjetër të ekonomisë. Një pikëpamje tjetër teorike pohon se kjo konkurrencë e madhe midis bankave ngushton hendekun midis normave të interesit, me të cilat përballen huadhënësit dhe huamarrësit dhe duhet kështu të çojë drejt rritjes më të shpejtë afatgjatë (Sinclair, 2000).

Megjithatë, industria bankare ka shumë tipare unike, që vështirësojnë vlerësimin e pasojave të rritjes së konkurrencës bankare. Siç vërehet nga Ward (2003), "një analizë e konkurrencës midis bankave duhet të pranojë cilësitë e veçanta të bankave. Në sektorin bankar, tregjet dështojnë në çdo mënyrë të mundshme: tregu karakterizohet nga rritja e kthimeve të shkallës (pra paguan për të qenë më i madh); bankat dhe klientët e tyre kanë një informacion shumë të pasaktë rreth njëri-tjetrit; e dështimet e bankave mund të shkaktojnë katastrofë dhe kështu krejt sistemi mbështetet nga ana financiare totalisht nga shteti". Kësaj mund t`i shtohet që bankat kanë rrezik dhe likuiditet shumë të lartë në krahasim me kompanitë e tjera dhe janë zakonisht më komplekse.

Lidhur me rritjen e kthimeve të shkallës, zakonisht bankat duhet të arrijnë një masë kritike për t`u bërë fitimprurëse. Kjo është arsyeja se pse mund të jetë më eficiente nga një pikëpamje makroekonomike

ekzistenca e njëfarë përqendrimi të tregut. Për të bërë një analogji me një sektor të ndryshëm, kompanitë e telekomit kanë investuar së tepërmi në rrjetet kabllore të fibrave optikë dhe kjo ka çuar në një mbikapacitet, në çmime jashtëzakonisht të ulëta dhe në rrezikun e falimentimit në shkallë të gjerë. Kështu, vala e fundit e shkrirjes së bankave, mbylljet dhe konsolidimi janë një dëshmi se degët e bankave me afro 20 m distancë nga njëra - tjetra mund të kenë qenë më konkurruese, por ishin jo eficiente.

Për problemin e parregullsisë së informacionit, secili ka nevojë t`i shohë në mënyrë të ndarë funksionet e depozitave dhe të huadhënies. Në aspektin e huadhënies, tregohet se cilësia mesatare e masës së gjerë të huamarrësve të bankave bie kur rritet numri i konkurruesve në treg, duke çuar në financimin e projekteve të pamundura ekonomikisht (Shaffer, 1998). Broecker (1990) dhe Riordon (1993) argumentojnë gjithashtu se rritja e konkurrencës mund të krijojë problemin e një zgjedhjeje të pafavorshme. Në një ekonomi ku ka shumë banka, të gjitha të motivuara për të zënë një pjesë të tregut, aplikanti për një hua të cilësisë së ulët ka më mundësi të marrë kredi, sesa në një ekonomi ku ekziston njëfarë përqendrimi i tregut bankar. Nga aspekti i depozitave, zakonisht dihet që depozitorët nuk mund të bëjnë dallime midis bankave të sigurta dhe bankave të pasigurta. Prandaj, në shumë vende, është vendosur një formë e sigurt rrjeti (sigurim depozite) për të mbrojtur, të paktën pjesërisht, interesat e depozituesve.

Megjithatë, siç vërehet nga Broaddus (2004), "duke njohur praninë e rrjetit të sigurisë financiare, edhe presionet konkurruese mund t`i nxisin bankat të veprojnë në mënyra që shtrembërojnë tregjet, që degradojnë sigurinë dhe besueshmërinë e sistemit bankar dhe që vënë në rrezik taksapaguesit." Një shembull i kohëve të fundit është dështimi i rreth 20 bankave në Turqi dhe kriza paralele ekonomike që i kushton taksapaguesve rreth 50 miliardë dollarë vetëm për t`i ardhur në ndihmë bankave në vështirësi. Bankat turke atëherë gëzojnë dhe abuzojnë me 100 për qind të garancive shtetërore mbi të gjitha depozitat. Një tipar tjetër unik i industrisë bankare është që problemet priren të prekin negativisht krejt sistemin. Kjo është akoma një arsye se pse qeveritë ndërhyjnë, shpesh në dëm të taksapaguesve, jo si në disa industri të tjera, ku zakonisht lejohen të dështojnë.

Bankat janë kompani me rrezikshmëri shumë të lartë dhe teoria e financës mbështet faktin se aksionerët e kompanive me rrezikshmëri të lartë janë më të gatshëm të ndërmarrin rrezik, pasi një sjellje e tillë mund të rrisë vlerën e fitimeve të tyre (nëse fitimet shihen në aspektin e një kërkese alternative mbi totalin e aseteve të një kompanie). Kjo është arsyeja se pse, nëse i lihet politikave të tyre, aksionerët do të financonin në norma të larta projekte me rrezik dhe do të siguronin kthime shumë të larta mbi fitimin e tyre, nëse këto projekte kanë sukses apo do t`i humbnin paratë e depozituesve kryesorë nëse jo. Kjo është edhe arsyeja se pse ekzistojnë rregullore strikte mbi huadhënien, mbi mjaftueshmërinë e kapitalit, ndaj ekspozimeve të mëdha ndaj rrezikut etj., sërish jo si në industritë e tjera.

Si përfundim, bankat janë korporata mjaft likuide e komplekse. Një bankë në vështirësi mund të vazhdojë të funksionojë për periudha të zgjatura dhe të bëhet një kërcënim më i madh për sistemin në progres. Pagesa e rrogave të personelit apo shpenzime të tjera, si dhe përmbushja e kërkesave të mbyllësve rastësorë të llogarive, përfaqësojnë një problem edhe për një bankë me një fitim negativ, për shkak të natyrës së likuiditetit të biznesit. Për më tepër, duke njohur kompleksitetin e operacioneve bankare, humbjet mund të fshihen nga mbikëqyrësit e pakët për periudha të gjata. Me fjalë të tjera, në një mjedis shumë konkurrues, nevojitet mjaft kohë që një bankë joeficiente e jofitimprurëse të falimentojë, veçanërisht nëse mbikëqyrja nuk është perfekte. Zakonisht, gjatë kësaj periudhe kohore, banka në vështirësi do të përpiqet me të gjitha mjetet që të zgjasë mbijetesën, duke përfshirë edhe financimin e projekteve me rrezik dhe të pamundura, duke ofruar norma depozitash jashtë tregut, fonde të kanalizuara drejt aksionerëve etj.; dhe kostot ekonomike të këtyre zakonisht do të mbahen nga taksapaguesi apo banka të tjera në sistem.

Prandaj nuk është e çuditshme që në vitet e fundit, shumë qeveri kanë patur kriza bankare pak kohë mbas liberalizimit dhe nxitjes së konkurrencës. Për më tepër, liberalizimi rrit dobësitë më tepër në vendet me institucione të dobëta (Demirguc-Kunt dhe Detragiache, 1998).

Me licencimin e fundit të bankave të reja dhe privatizimit të Bankës së Kursimeve, sot 17 banka në Shqipëri po përpiqen të

fitojnë një pjesë të tregut të një totali prej 3.5 miliardë dollarësh depozita dhe rreth 0.5 miliardë dollarë hua. Nëse edhe ne marrim parasysh që Banka e Kursimeve, sot Raiffeisen, mban më shumë se gjysmën e depozitave të tregut, do të bëhet më e qartë se ekziston një konkurrencë e ashpër midis 16 bankave të tjera. Eshtë gjithashtu e dukshme se kthimet mbi kapitalin për këto banka, pothuajse të gjitha pronë e kapitalit të huaj, kanë qenë shumë tërheqëse për një investitor të huaj duke njohur rrezikun e lidhur me të. Është gjithashtu e vërtetë se sektori bankar në Shqipëri gëzon një shumëllojshmëri shërbimesh dhe një nivel më të lartë teknologjie se çdo sektor tjetër në vend. Në përfundim, diferenca ndërmjet normave të depozitave dhe huave njëvjeçare tani është diçka ndërmjet 5 – 6 pikë përqindjeje, gjë që i afrohet shumë shumicës së vendeve të rajonit. Të gjitha këto janë shenja që ka një nivel të lartë konkurrence në sektorin bankar; nëse ka shumë konkurrencë, këtë do ta tregojë koha. Por, implikimi i dukshëm është se Banka e Shqipërisë, mbikëqyrësi i vetëm i sistemit, duhet të jetë shumë më e kujdesshme sot se asnjëherë.

LITERATURË

Broaddus, J. A., 2004, "Competition in Banking: Achieving the Right Balance," Bank Structure Conference by the Federal Reserve Bank of Chicago.

Broecker, T., 1990, "Creditworthiness Tests and Interbank Competition," Econometrica, 58, pp. 429-452.

Demirguc-Kunt, A. and E. Detragiache, 1998, "Financial Liberalisation and Financial Fragility," IMF Working Paper, 1998/83, June.

Riordan, M., 1993, Competition and bank performance: a theoretical perspective, Cambridge University Press.

Sinclair, P. J. N., 2000, "Central Banks and Financial Stability," Bank of England Quarterly Bulletin, pp. 384-389

Ward, J., 2003, "What is so Great About Competition in Banking?", available on www.cerf.com.ac.uk

*Seyhan Pencapligil: Drejtor i Përgjithshëm, Banka Kombëtare Tregtare, Shqipëri.